



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES · REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISE · OPSTINA VITINA

|                          |                          |                          |                          |
|--------------------------|--------------------------|--------------------------|--------------------------|
| 02-02-2026               |                          |                          |                          |
| 1. Komiteti<br>për Ligje | 2. Komiteti<br>për Ligje | 3. Komiteti<br>për Ligje | 4. Komiteti<br>për Ligje |
| 01-                      | 110/                     | 05-                      | 152                      |



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë, në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2, shkronja d, neni 40, paragrafi 40.2, pika e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), të nenit 14, paragrafi 1 dhe paragrafi 8.1 të Rregullores (QRK) Nr.19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, nenit 36, paragrafi 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 30.01.2026 miraton këtë:

## V E N D I M

**për miratim të dy anëtarëve të Komisionit për vlerësimin dhe përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve për institucionet edukativo arsimore të nivelit parafillor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë në Komunën e Vitisë**

### Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për dy anëtarët e propozuar për komisionin për vlerësimin dhe përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve për institucionet edukativo arsimore të nivelit parafillor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë në Komunën e Vitisë.

### Neni 2

Anëtarët e komisionit të propozuar nga DKA, të miratuar nga Kuvendi Komunal ka këtë përbërje:

1. Zijadin Ahmeti, kryetar i komisionit, zyrtar i DKA-së
2. Drita Pira, Drejtore e SHFMU "Halil Alidema", Pozharan
3. Një anëtar nga MASHTI-i, \_\_\_\_\_

### Neni 3

Përmes këtij vendim konfirmojmë se, personat (nr. rendor 1 dhe 2) e shënuar më lartë përmbushin kriteret të jenë anëtarë të Komisionit, sipas Rregullores 19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar, kurse anëtari nga MASHTI, do të vendoset pas kontaktit mes DKA-së me MASHTI-in.

### Neni 4

Periodha kohore e mandatit të anëtarëve të lartëcekur do të jetë njëvjeçare nga momenti i miratimi të këtij vendimi.

### Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit dhe Drejtoria për Arsim e Komunës së Vitisë.

### Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 10, pika 6 të Ligjit për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Nr. 08/L-284, (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.24/27 Dhjetor 2024), dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhën zyrtare në web faqen e Komunës së Vitisë

Vendimi u dorëzohet:

1. Anëtarëve të komisionit;
2. Zyrës së Kryetarit;
3. Drejtoria për Arsim; dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË

K R Y E S U E S I

Bekim Azizi

